

## AKT THEMELIMI I SHOQËRISË

### "DARDA" SH.P.K.

Sot, me datë 04.09.2024,

- **Z. Hevzi Cuci**, shtetas shqiptar, i biri i Ramadan dhe Rizafete lindur me 03.02.1977, në Gjilan, banues në Rruga "Qarkore", Gjilan 60000, Kosovë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal Nr.1013275501, madhor e me zotësi të plote juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**DARDA**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

#### NENI 1 EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**DARDA**" SH.P.K.

#### NENI 2 SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Tish Daija", Kompleksi KIKA, Pallati 5, Kati 2, Njesia Bashkiake Nr.5, Tirane.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

#### NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

#### NENI 4 OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Magazinimi dhe ruajtja e mallrave;
- Ndërtimi i ndërtesave;
- Punime inxhinjerie
- Punime të specializuara ndërtimi
- Tregtia e automjeteve

- Tregtia me shumicë, përveç automjeteve dhe motorcikletave
- Transporti tokësor dhe me tubacione
- Transporti ujor
- Transporti ajror
- Magazinimi dhe aktivitete mbështetëse për transportin
- Transporti rrugor i mallrave;
- Akomodimi
- Shërbime ushqimi dhe pije
- Aktivitete publikimi
- Telekomunikacioni
- Shërbime të teknologjisë së informacionit
- Aktivitete të shërbimit të informacionit
- Aktivitetet e mbrojtjes;
- Aktivitete të shërbimeve financiare, përveç sigurimeve dhe financimit të pensioneve
- Aktivitete të tjera financiare
- Aktivitete të pasurive të paluajtshme
- Aktivitete të drejtimit të ndërmarrjeve dhe aktivitete të konsultimi
- Aktivitete arkitekture dhe inxhinjerike; aktivitete të kontrolleve dhe analizave teknike
- Kërkim dhe zhvillim shkencor
- Publiciteti dhe kërkimet e tregut
- Aktivitete të sigurimit dhe hetimit
- Aktivitetet e rendit dhe të sigurisë publike;
- Shërbime ndaj ndërtesave dhe shesheve
- Administrim zyrash, mbështetje administrative dhe të tjera aktivitete mbështetëse të ndërmarrjeve
- Aktivitetete të tjera shërbimi
- Aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike
- Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor;
- Trajtimi i transportit "cargo";
- Aktivitete të marrjes e dhënies me qira
- Aktivitete të punësimit
- Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim;
- Marrja dhe dhënia me qira (leasing) i veturave dhe automjeteve të lehta motorike;
- Marrja dhe dhënia me qira (leasing) e makinerisë dhe pajisjeve bujqësore;
- Marrja dhe dhënia me qira (leasing) e makinerisë dhe pajisjeve të ndërtimit dhe inxhinierisë;
- Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku;
- Prodhimi i aluminit;
- Ndërtimi i objekteve të banimit dhe të tjera;
- Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake;
- Prodhimi i parketit për dysheme;
- Prodhimi i pëlhurave të paendura dhe artikujve të paendur, përveç veshjeve;
- Prodhimi i tekstileve të tjera teknike dhe industriale;
- Prodhimi i produkteve të tjera metalike.

# DARDA

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 100.000 Lek (*njeqind mije*) Lek dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Hevzi Cuci**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 Lek (*njeqind mije*) Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- **Z. Hevzi Cuci**, shtetas kosovar, lindur më 03.02.1977, në Gjilan, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal Nr. 1013275501, madhor e më zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## NENI 7 LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

# DARDA

## NENI 8 DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Z. Hevzi Cuci* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES  
HEVZI CUCI



Hevzi Cuci

